

Innovation as a key instrument for the performance and competitiveness of agricultural and agritourism farms in Albania

**Denisa Kurtaj^{1*}, Ilir Tomorri¹, Brunilda Baraku¹, Adela Çulani¹,
Fabjola Domi¹, Nertila Filipi¹**

¹Faculty of Economy and Agribusiness, Agricultural University of Tirana, Albania

*Corresponding author; E-mail: dpipero@ubt.edu.al

Abstract

Agriculture is a significant economic sector in Albania, contributing substantially to the country's GDP and the number of employees. In this sector, over 300 thousand agricultural farms operate, most of which are micro and small, with land areas of up to 2 hectares. Innovation is considered a vital component in enhancing the performance and sustainability of agricultural farms, especially in developing economies such as Albania. This study examines how innovation affects the performance of agricultural farms and the sustainable development of Albania's rural sector. Data was collected from 672 respondents across 12 regions, including both agricultural and agritourism farms, through face-to-face interviews. The data was processed with the SPSS program, aligned with the study's objectives. The results show that innovation plays a critical role in increasing the performance and competitiveness of agricultural farms and agritourism enterprises, improving productivity, cost reduction and increased income. Innovation in Albania's agricultural sector faces structural barriers, such as costs of implementing technologies, limited access to finance, lack of necessary digital infrastructure, insufficient farmers' skills and knowledge, and support from public institutions. The study highlights the need for the design of policies and support mechanisms. Promoting innovation is crucial to boost agritourism, enhance farm performance, as well as the sustainable development of the rural sector.

Keywords: innovation, digital technologies, farm performance, productivity, sustainable rural development

JEL Codes: O13, O31, Q01, Q16

Hyrje

Sektori bujqësor është një nga sektorët më të rëndësishëm në Shqipëri, referuar kontributit në rritjen ekonomike, produktin e brendshëm bruto dhe nivelin e punësimit në vend. Pavarësisht rëndësisë së tij ekonomike, sektori përballet me sfida të vazhdueshme, duke përfshirë shpopullimin rural të shkaktuar nga migrimi i të rinjve, aksesin e kufizuar në financime, rritjen e produktivitetit të fermave bujqësore, efikasitetin e përdorimit të burimeve dhe nivelet e ulëta të përvetësimit të teknologjisë.

Inovacioni njihet gjerësisht si një nxitës kryesor i produktivitetit, efikasitetit të burimeve dhe konkurrueshmërisë në bujqësi, me impakt pozitiv për qëndrueshmërinë ekonomike, sociale dhe mjedisore (FAO, 2018; Campuzano et al., 2023; Benfica et al., 2023).

Inovacioni në bujqësi përfshin një gamë të gjerë procesesh dhe praktikash, të tilla si zbatimi i teknologjive të reja, sistemeve të reja të menaxhimit, përdorimi i mjeteve dixhitale, produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar, që çojnë në përmirësimin e performancës së fermave (FAO, 2018). Për më tepër, inovacioni u mundëson fermerëve të përshtaten me ndryshimet e tregut, kufizimet mjedisore dhe preferencat e konsumatorëve (Diao et al., 2023; Olum et al., 2018).

Teknologjitë dixhitale, rrisin efikasitetin, nxisin inovacionin, reduktojnë kostot e transaksioneve, lehtësojnë shkëmbimin dhe ndarjen e informacionit, përmirësojnë shërbimet e ekstensionit për fermerët, mbështesin ekonomitë e shkallës duke mundësuar modele inovative biznesi, përmirësojnë menaxhimin e zinxhirit të vlerës në sektorin bujqësor (World Bank, 2016).

Dixhitalizimi dhe inovacioni mundëson një vendimmarrje më të mirë për fermerët, duke ndihmuar në përmirësimin e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së fermave bujqësore (OECD, 2013; MSU-Manage, 2021). Dixhitalizimi është një dimension gjithnjë e më i rëndësishëm i inovacionit bujqësor, duke përfshirë teknologjitë që variojnë nga mjetet bazë të komunikimit deri te sistemet e përparuara siç është inteligjenca artificiale.

Në vendet në zhvillim, teknologjia e informacionit ofron një sërë shërbimesh dhe lehtësira për fermerët dhe aktorët e tjerë të përfshirë në zinxhirin e vlerës, duke përmirësuar komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre. Përfshirja, efikasiteti dhe inovacioni janë mekanizmat kryesorë për teknologjinë dixhitale për të nxitur zhvillimin në zonat rurale

Inovacioni dhe teknologjitë dixhitale kanë potencialin për të përmirësuar vendimmarrjen, për të rritur efikasitetin e shërbimeve për fermerët, për të ulur kostot e transaksioneve, për të lehtësuar integrimin në zinxhirët e vlerës dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e sistemeve bujqësore (Blakeney, 2022; Tomori et al, 2024). Zbatimi i teknologjive dixhitale nga sipërmarrjet është forca kryesore lëvizëse për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (Prasetyo & Setyadharna, 2022).

Studimet tregojnë se bujqësia dixhitale mund të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve, të rrisë aksesin në treg dhe të nxisë rezistencën ndaj sfidave të tilla si ndryshimet klimatike, shpopullimi rural dhe ndryshimet demografike.

Procesi i dixhitalizimit ka potencialin për të sjellë ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si funksionon bujqësia, për sa i përket përdorimit të mjeteve, pajisjeve dhe platformave teknologjike, për të ofruar një qasje inovative dhe mënyra të reja në organizimin e prodhimit dhe efikasitetin e fermave bujqësore.

Agroturizmi, si një sektor potencial zhvillimi, mund të jetë “opsioni i zgjuar dhe i qëndrueshëm”, duke u përqendruar në burime specifike dhe duke sjellë përfitime ekonomike dhe sociale, sa i përket diversifikimit të aktiviteteve dhe shërbimeve, ideve dhe praktikave të sipërmarrësve vendas, strategjive të përshtatshme të menaxhimit dhe teknologjive moderne (Holland et al., 2022).

Pavarësisht rëndësisë së inovacionit në zhvillimin e sektorit rural, në Shqipëri adaptimi dhe zbatimi i praktikave inovative ndryshon sipas rajonit dhe nivelit të fermës. Barrierat strukturore, të tilla si qasja e kufizuar në financime, mungesa e njohurive dhe aftësive profesionale, dhe mbështetja e pamjaftueshme institucionale, vazhdojnë të pengojnë përhapjen e inovacionit, veçanërisht për fermat dhe sipërmarrjet e vogla. Inovacioni konsiderohet një instrument i rëndësishëm për të adresuar këto sfida. Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore, si dhe i infrastrukturës së nevojshme, është thelbësore për të lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit midis fermerëve dhe aktorëve të tjerë.

Një rol të rëndësishëm në transferimin e njohurive, trajnimin dhe këshillimin e fermerëve për zbatimin e praktikave inovative dhe teknologjive dixhitale në sektorin bujqësor, luajnë institucionet publike, agjensitë e ekstensionit bujqësor në bashkëpunim me universitetet dhe aktorë të tjerë.

Duke marrë në konsideratë rolin dhe rëndësinë e inovacionit dhe dixhitalizimit, qeveria shqiptare ka hartuar disa dokumente strategjike për t'i përfshirë ato në strategjitë e saj të zhvillimit bujqësor dhe rural. Përmes këtyre dokumenteve dhe strategjive, synohet të promovohet, përdorimi i teknologjive të informacionit, inovacionit dhe përmirësimit të infrastrukturës dixhitale, duke përfshirë dhe sektorin bujqësor.

Gjetjet e këtij studimi synojnë të nxisin bashkëpunimin midis institucioneve publike, akademike dhe aktorëve të tjerë, për të kontribuar në hartimin e politikave dhe strategjive që promovojnë dhe mbështesin zbatimin e inovacionit në sektorin bujqësor në Shqipëri.

Rishikimi i Literaturës

Sektori bujqësor vazhdon të përballet me sfida të rëndësishme, duke përfshirë produktivitetin e ulët, pronësinë e fragmentuar të tokës, integrimin e kufizuar të tregut dhe ndjeshmërinë e lartë ndaj luhatjeve klimatike dhe ekonomike. Inovacioni po bëhet gjithnjë e më shumë një nxitës kyç për transformimin bujqësor dhe zhvillimin rural, veçanërisht në kontekstin e vendeve në zhvillim, siç është Shqipëria. Literatura thekson rëndësinë e inovacionit si katalizator për përmirësimin e produktivitetit, efikasitetin e burimeve, rritjen e konkurrueshmërisë dhe promovimin e qëndrueshmërisë në sektorin bujqësor (FAO, 2018; OECD/Eurostat, 2018).

Kuadri Konceptual për Inovacionin Bujqësor

Inovacioni dhe dixhitalizimi në bujqësi janë thelbësor për rritjen e konkurrueshmërisë, veçanërisht në ekonominë në zhvillim. Sipas Manualit të Oslos (OECD/Eurostat, 2018), inovacioni përkufizohet si “një produkt ose proces i ri, i përmirësuar ose kombinim i tyre që është dukshëm i ndryshëm nga produktet ose proceset e mëparshme për përdoruesit dhe konsumatorët potencialë”.

Inovacioni në bujqësi përfshin një gamë të gjerë procesesh dhe praktikash, të tilla si zbatimi i teknologjive të reja, zbatimi i sistemeve të reja të menaxhimit, përdorimi i mjeteve dhe platformave dixhitale, produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar, që çojnë në përmirësimin e performancës së fermave bujqësore (FAO, 2018).

Ato përfshijnë inovacione teknologjike, (smart farming, platforma dixhitale), inovacione organizative (modele të reja biznesi, rrjete bashkëpunuese), dhe inovacione institucionale (shërbimet e ekstensionit, transferimin e njohurive, aksesin në treg). Inovacioni është rezultat i aktiviteteve kërkimore, shkencore, teknologjike, organizative, financiare, tregtare, si dhe ato që lidhen me investimet në njohuri, të cilat synojnë të zbatojnë praktika inovative (OECD-Eurostat, 2018). Inovacioni është një faktor kyç i konkurrueshmërisë dhe performancës, edhe për sipërmarrjet e agroturizmit që operojnë në sektorin rural, për sa i përket produkteve, shërbimeve, proceseve të menaxhimit dhe kapaciteteve institucionale (Kurtyka-Marcak & Kutkowska, 2017).

Inovacioni dhe ndikimi në performancën e fermave bujqësore dhe agroturistike

Studimet të ndryshme empirike kanë dëshmuar se ekziston një korrelacion i fortë midis adoptimit të inovacionit dhe rritjes së performancës së fermave. Rritja ekonomike nxitet nga zbatimi i teknologjive dixhitale dhe praktikave të inovacionit (Parikoglou et al., 2024). Inovacioni mbështet përfshirjen sociale duke lehtësuar aksesin në trajnim, duke nxitur pjesëmarrjen e të rinjve dhe grave dhe duke fuqizuar komunitetet në zonat rurale (Bhujel & Joshi, 2024).

Në sektorin bujqësor në vendin tonë, ku mbizotërojnë fermat e vogla dhe të mesme, inovacioni dhe dixhitalizimi, përbën një faktor thelbësor për modernizimin e bujqësisë, transformimin dhe zhvillimin rural (Fuetsch, 2022).

Transformimi dixhital në sektorin bujqësor, nxit përmirësimin e efikasitetit dhe produktivitetit, modernizimin e sistemeve bujqësore, diversifikimin e aktiviteve, dhe rritjen e të ardhurave (Šermukšnyte & Melnikienem, 2024; Ferrari et al., 2022; Finger, 2023).

Zhvillimi i qëndrueshëm, do të çoj në rritjen e produktivitetit të fermave bujqësore, konkurrueshmërisë dhe përmirësimit të standardit të jetesës së popullsisë në zonat rurale.

Agroturizmi në vendet në zhvillim është thelbësor për zhvillimin rural dhe diversifikimin ekonomik të aktiviteve, rritjen e punësimit dhe të ardhurave të fermerëve, si dhe zbutjen e varfërisë në zonat rurale (Roman et al., 2020). Agroturizmi në vendin tonë përbën një sektor në zhvillim me potencial të madh. Vendndodhja gjeografike, peizazhet e jashtëzakonshme, tradita e gjatë e mikpritjes, kuzhina e pasur me produkte tradicionale e bëjnë Shqipërinë, një vend me potencial për zhvillimin e sektorit të agroturizmit (Domi et al., 2023). Në këtë kontekst, këto praktika inovative kontribuojnë jo vetëm në performancën operative dhe ekonomike të fermave bujqësore, por edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale.

Pengesat dhe faktorët për zbatimin e inovacionit në sektorin bujqësor

Adaptimi dhe zbatimi i inovacionit në sektorin bujqësor, ndikohet nga një sërë faktorësh kompleksë ekonomikë, socialë, teknikë dhe institucionalë. Hulumtimet dhe studimet empirike, identifikojnë disa pengesa për zbatimin e inovacionit në zonat rurale, të tilla si qasja e kufizuar në burimet financiare, njohuritë profesionale dhe aftësitë e fermerëve, shërbimet e pamjaftueshme të ekstensionit, fragmentimi i tokës, infrastruktura e dobët dixhitale, rreziku dhe pasiguria në kthimet e investimeve dhe mbështetja e pamjaftueshme institucionale (OECD, 2019; Mulliri et al., 2022; Tomorri et al., 2025).

Fermerët dhe sipërmarrjet bujqësore përballen me rreziqe prodhimi, të tilla si rendiment i ulët dhe cilësi e dobët, për shkak të problemeve të tilla si produktiviteti dhe cilësia e tokës, dëmtuesit, sëmundjet, farat dhe fidanët e papërshtatshëm (Murrja et al., 2023). Faktorë të ndryshëm rreziku gjenden në aktivite të ndryshme të prodhimit dhe në periudha të ndryshme. Prandaj, ngjarjet e rrezikut duhet të studiohen për secilën sipërmarrje dhe në çdo kohë (Kurtaj et al., 2024). Pavarësisht këtyre barrierave, disa faktorë mund të nxisin adaptimin e inovacionit në sektorin bujqësor, siç janë mbështetja financiare nga institucionet publike, investimet në burimet njerëzore (transferimi i njohurive dhe aftësive dixhitale të fermerët), bashkëpunimi midis aktorëve të ndryshëm, zhvillimi i infrastrukturës dixhitale, promovimi dhe investimi në sektorin e agroturizmit (Balayev & Mirzayev, 2022).

Faktorët nxitës që ndikojnë në procesin e inovacionit, janë të ndryshëm dhe të një natyre të ndryshme për kompanitë që operojnë në sektorin agroushqimor (Apicella dhe Tarabella, 2024). Rritja e aftësive dhe njohurive profesionale, veçanërisht te fermerët e vegjël, për të menaxhuar me sukses sipërmarrjet e tyre bujqësore, kërkon investime të qëndrueshme.

Mbështetja dhe financimi nga institucionet qeveritare për institucionet e kërkimit dhe zhvillimit lehtëson transferimin e teknologjisë në fermat bujqësore përmes agjensive bujqësore dhe mundëson infrastrukturën e duhur për zbatimin e inovacionit (Annosi et al., 2022; Chmieliński & Wieliczko, 2022; Frick et al., 2024).


Referuar rolit dhe rëndësisë së inovacionit dhe dixhitalizimit, qeveria shqiptare ka hartuar disa dokumente strategjike për t'i përfshirë ato në strategjitë e saj të zhvillimit bujqësor dhe rural. Përmes këtyre strategjive, synohet të promovohet, përdorimi i teknologjive të informacionit, inovacionit dhe përmirësimit të infrastrukturës dixhitale, duke përfshirë dhe sektorin bujqësor.

Në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, (2014-2020), synohet të promovohet dhe përfshihet inovacioni në zhvillimin bujqësor dhe rural. Në Strategjinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, (2021-2027), përcaktohet zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative, bashkëpunimi midis aktorëve, transferimi i njohurive dhe inovacionit në bujqësi dhe sektorin rural. Është e rëndësishme të forcohen dhe konsolidohen Sistemet e Njohurive dhe Inovacionit Bujqësor (SNIB), të rritet përvetësimi i njohurive të avancuara dhe profesionale, investimet në teknologji dhe dixhitalizimin e bujqësisë (EIP-AGRI,2021; MARD, 2022; MARD, 2024).

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZhBR), Qendrat për Transferimin e Teknologjive Bujqësore (QTBB), Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), luajnë një rol të rëndësishëm në këshillimin dhe trajnimin e fermerëve, si dhe në lehtësimin e procesit të transferimit të njohurive në lidhje me përdorimin e teknologjive dixhitale dhe praktikave inovative në fermat bujqësore. Një rol të rëndësishëm në shkëmbimin dhe transferimin e njohurive, edukimit dhe trajnimit të fermerëve në kuadër të Sistemeve të Njohurive dhe Inovacionit Bujqësor në Shqipëri, luajnë universitetet dhe institucionet kërkimore (Kolaj et al., 2024). Bashkëpunimi midis institucioneve publike, agjensive të ekstensionit bujqësor, universiteteve dhe aktorëve të tjerë, luajnë një rol kyç në hartimin e politikave dhe strategjive, për nxitjen e inovacionit dhe dixhitalizimit në sektorin bujqësor. Ky studim kontribuon duke ofruar të dhëna empirike, që fokusohen në ndikimin dhe rolin e inovacionit në rritjen e performancës dhe konkurrueshmërisë së fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve agroturistike, në vendin tonë.

Struktura e punimit është paraqitur në figurën e mëposhtme:

Figura 1. Struktura e studimit



Burimi: Kompozim i autorëve, 2025

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë rolin e inovacionit në performancën dhe produktivitetin e fermave bujqësore dhe agroturistike në Shqipëri.

Objektivat specifike të studimit janë:


- a) Cilat janë praktikatat e inovacionit të zbatuara në nivel ferme dhe sipërmarrjet agroturistike në vendin tonë?
- b) Cili është roli dhe ndikimi i inovacionit në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor?
- c) Cilat janë sfidat dhe barrierat, për aplikimin e praktikave inovative nga fermat bujqësore dhe agroturistike në sektorin bujqësor?

Metoda dhe procedurat

Metodologjia e përdorur për këtë punim bazohet në mbledhjen, përpunimin, analizën dhe interpretimin e të dhënave dhe treguesve statistikorë, të fokusuar në shqyrtimin e rolit të inovacionit në performancën e fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve agroturistike në Shqipëri. Në përputhje me qëllimin e studimit, të dhënat primare u mbledhën përmes plotësimit të pyetësorëve, dhe të dhëna dytësore të publikuara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

Bazuar në objektivat e këtij studimi, metodologjia është strukturuar për të ofruar një analizë gjithëpërfshirëse, duke kombinuar qasjet sasore dhe cilësore të kërkimit. Kuadri konceptual për metodologjinë, paraqitet në figurën e mëposhtme:

Figura 2. Kuadri konceptual i metodologjisë



Burimi: Kompozim i autorëve, 2025

Në funksion të qëllimit dhe objektivave të studimit, pyetësi u hartua për të mbledhur të dhëna dhe informacion mbi perceptimet dhe vlerësimet e fermerëve për rolin dhe ndikimin e inovacionit në aktivitetet e fermave dhe sipërmarrjeve. Studimi u shtri në të gjitha rajonet e vendit, duke marrë parasysh shpërndarjen gjeografike, përqendrimin dhe tipologjinë e fermave bujqësore dhe agroturistike të orientuara drejt inovacionit.

Bazuar në të dhënat e INSTAT&MARD (2024), mbi aktivitetet dhe tipologjinë e fermave, pyetësorët u plotësuan ballë për ballë me fermerët, pronarët, menaxherët e sipërmarrjeve agroturistike dhe fermat bujqësore për rajonet e përfshira në studim.

Pyetësi është i strukturuar në disa seksione kryesore, ku sigurohet informacion dhe të dhëna mbi:

- Karakteristikat socio-ekonomike të të anketuarve (gjinia, mosha, vendbanimi, arsimi, punësimi, etj.),
- Informacion mbi fermat bujqësore/agroturistike (vendndodhja, kohëzgjatja e biznesit, numri i punonjësve, aktivitetet, investimet, të ardhurat, treguesit e performancës etj.),
- Të dhëna mbi aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga fermat bujqësore dhe sipërmarrjet agroturistike,

- Të dhëna mbi inovacionin (qëndrimi dhe perceptimi ndaj inovacionit, llojet e dhe praktikat inovative të zbatuara, roli dhe ndikimi i inovacionit në performancën e fermave bujqësore dhe agroturistike),
- Të dhëna mbi sfidat, faktorët dhe pengesat në zbatimin e inovacionit në sektorin bujqësor.

Pyetjet kërkimore në përputhje me qëllimin dhe objektivat e studimit janë:

- Çfarë idesh dhe praktikash inovative keni aplikuar në agroturizmin/fermën tuaj?
- Si ka ndikuar inovacioni në efikasitetin e aktiviteteve dhe shërbimeve në biznesin tuaj?
- Si e vlerësoni rolin e inovacionit në performancën e agroturizmit/fermës suaj?
- Cilat janë pengesat dhe faktorët nxitës për adaptimin e inovacionit në agroturizmin/fermën tuaj?

Plotësimi i pyetësorëve u realizua përgjat një periudhe 3-mujore, të vitit 2025. Gjithsej u plotësuan 672 pyetësorë, ku të dhënat u analizuan dhe u përpunuan më tej me programin SPSS. Të dhënat u analizuan duke përdorur metoda statistikore përshkruese dhe eksploruese, në përputhje me qëllimin dhe objektivat e studimit.

Rezultatet e vlerësimit

Studimet empirike kanë konfirmuar një korrelacion të fortë midis inovacionit, performancës dhe produktivitetit të fermave bujqësore dhe agroturistike. Inovacioni po bëhet gjithnjë e më shumë një faktor kyç për transformimin bujqësor dhe zhvillimin rural, veçanërisht në kontekstin e vendeve në zhvillim, siç është Shqipëria. Ai konsiderohet një komponent i rëndësishëm në përmirësimin e performancës dhe konkurrueshmërisë së fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve të agroturizmit.

Roli i inovacionit është i shumëfishtë: lehtëson aksesin në treg, përmirëson gjurmueshmërinë dhe sigurinë ushqimore, përmirëson aksesin në informacion dhe komunikimin midis aktorëve në zinxhirin e vlerës, rrit produktivitetin dhe efikasitetin në përdorimin e burimeve, ul kostot, rrit të ardhurat, ndikon në rritjen e punësimit në zonat rurale. Gjatë dekadës së fundit, ka pasur zhvillime të rëndësishme pozitive në sektorin rural në Shqipëri, për sa i përket strategjive dhe programeve qeveritare përmes granteve dhe subvencioneve për të mbështetur idetë dhe praktikat inovative të fermerëve në aktivitetet e tyre.

Në përputhje me qëllimin dhe objektivat e studimit, të dhënat e mbledhura nga pyetësorët dhe rezultatet janë si më poshtë:

Tabela 1. Shpërndarja e pyetësorëve të plotësuar sipas rajoneve

Nr	Rajoni	Nr i pyetësorëve	Përqindja
1	Berat	54	8.0%
2	Dibër	25	3.7%
3	Durrës	61	9.1%
4	Elbasan	45	6.7%
5	Fier	106	15.8%
6	Gjirokastrë	67	10.0%
7	Korçë	101	15.0%
8	Kukës	20	3.0%
9	Lezhë	51	7.6%
10	Shkodër	28	4.2%
11	Tiranë	63	9.4%
12	Vlorë	51	7.6%
*	Total	672	100%

Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025

Referuar të dhënave në tabelën e mësipërme, u plotësuan gjithsej 672 pyetësorë, të shpërndarë në 12 rajone të vendit, duke ofruar një mostër të gjerë dhe përfaqësuese të fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve agroturistike. Kjo shpërndarje gjeografike e të dhënave, është e rëndësishme për të analizuar zbatimin e praktikave inovative, rolin dhe impaktin e inovacionit në performancën e fermave bujqësore në rajonet e marra në studim.

Tabela 2. Karakteristikat e të intervistuarve

Nr	Karakteristikat	Frekuenca	Përqindje
I	Gjinia		
a	Femër	84	12.5%
b	Mashkull	588	87.5%
*	Total	672	100.0%
II	Mosha		
a	18-30	42	6.2%
b	31-40	117	17.4%
c	41-50	129	19.2%
d	51-60	176	26.2%
e	Mbi 60	208	31.0%
*	Total	672	100%
III	Arsimi		
a	Arsimi bazë	131	19.5%
b	Arsimi i mesëm	231	34.4%
c	Arsimi profesional	103	15.3%
d	Arsimi i lartë (Master, PhD)	207	30.8%
*	Total	672	100%

IV	Pozicioni		
a	Pronar	177	26.3%
b	Menaxher	49	7.3%
c	Pronar dhe menaxher	419	62.4%
d	Të tjera	27	4.0%
*	Total	672	100%


Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025

Të dhënat e mësipërme tregojnë se (87.5%) e fermerëve të intervistuar janë meshkuj dhe (12.5%) e tyre janë femra. Sa i përket moshës së tyre, shumica e të intervistuarve (31%) janë mbi 60 vjeç, (26.2%) janë të moshës 51-60 vjeç, (19.2%) janë të moshës 41-50 vjeç, (17.4%) janë të moshës 31-40 vjeç dhe (6.2%) janë të moshës 18-30 vjeç.

Sa i përket nivelit të edukimit/arsimit, rezultojnë se (19.5%) e të intervistuarve kanë arsimin bazë, (34.4%) kanë arsimin e mesëm, (15.3%) kanë arsim profesional dhe (30.8%) kanë arsim të lartë. Sa i përket pozicioneve të tyre, shumica e të anketuarve (62.4%) janë pronarë dhe menaxherë, (26.3%) janë pronarë, (7.3%) menaxherë dhe (4%) të tjerë.

Ky informacion është i rëndësishëm, për të kuptuar profilin, përvojën, moshën, pozicionin dhe strukturën e arsimit të drejtuesve të fermave dhe mund të ketë implikime të rëndësishme për zhvillimin e programeve të trajnimit dhe politikave mbështetëse për të përmirësuar njohuritë dhe kapacitetin e drejtuesve, në drejtim të përvetësimit dhe zbatimit të praktikave inovative në fermat bujqësore dhe sipërmarrjet agroturistike.

Figura 3. Profili i agroturizmit/fermës tuaj




Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025

Referuar të dhënave për profilin e biznesit, rezulton se (78 ose 11.6%) janë ferma të çertifikuara agroturistike, (111 ose 16.5%) janë ferma me aktivitete agroturistike dhe (483 ose 71.9%) janë ferma bujqësore.

Ky informacion është i rëndësishëm për të kuptuar strukturën dhe profilin e fermave bujqësore dhe ka implikime të rëndësishme në planifikimin e politikave në të ardhmen në drejtim të diversifikimit të aktiviteteve, rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve agroturistike.


Figura 4. Numri i të punësuarve në fermën/agroturizmin tuaj



Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025

Sa i përket të dhënave në grafikun e mësipërm, rezulton se (69%) e fermave bujqësore dhe agroturistike kanë 1-4 punonjës, (19%) e tyre, kanë 5-9 punonjës dhe (12%) kanë mbi 10 punonjës.


Figura 5. Sipërfaqja e tokës në agroturizëm/fermë



Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025

Sa i përket të dhënave për sipërfaqen e tokës, rezulton se (28.4%) e fermave bujqësore dhe agroturistike kanë deri 1 ha, (31.7%) kanë 1-3 ha, (7.3%) kanë 3-5 ha, (9.5%) kanë 5-10 ha, (8.8%) kanë 10-20 ha dhe (14.3%) kanë mbi 20 ha.

Figura 6. Burimet e investimit në agroturizmin/fermën tuaj




Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025

Referuar të dhënave për burimet e financimit/investimit, rezulton se (71%) e fermave bujqësore dhe agroturistike, financojnë investimet me burimet/kapitalin e vet, (26%) me kredi/hua bankare, (13%) me grant/subvencione nga institucionet qeveritare, (9%) të ardhura nga emigracioni dhe (11%) burime të tjera.


Ky informacion është i rëndësishëm për të kuptuar planet e pronarëve/drejtimesve të fermave për investimet e tyre në të ardhmen dhe mund të ndihmojë në hartimin e politikave dhe programeve nga institucionet dhe agjensitë publike, për të inkurajuar dhe mbështetur investimet në sektorin bujqësor.

Figura 7. Aktivitetet që ofroni në fermën tuaj



Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025


Figura 8. Aktivitetet/shërbimet që ofroni në agroturizmin tuaj



Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025

Në grafikët e mësipërm, pasqyrohen të dhënat për aktivitetet dhe shërbimet e ofruara në fermat bujqësore dhe agroturistike. Sa i përket aktiviteteve në fermë, peshën kryesore e zënë (aktivitetet për pentore, perime, blegtori dhe vreshtari). Lidhur me aktivitetet/shërbimet e ofruara nga sipërmarrjet agroturistike, peshën kryesore e zënë, (shërbimet në restorant, përpunimi i produkteve bujqësore/blegtorale, degustimi i produkteve të fermës, akomodimi në bujtinë/fermë, etj.).


Figura 9. Performanca/ecuria e biznesit tuaj



Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025

Sa i përket të dhënave për performancën e biznesit, rezulton se për (63%) e fermave bujqësore dhe agroturistike është në rritje, (30%) njëlloj, dhe (7%) në ulje. Ky informacion është i rëndësishëm për të kuptuar nevojën në hartimin e politikave për nxitjen dhe inkurajimin e zbatimit të inovacionit nga fermat dhe sipërmarrjet në sektorin bujqësor. Treguesit përkatës, lidhur me rolin dhe ndikimin që inovacioni ka në efikasitetin dhe performancën e fermave bujqësore dhe agroturistike, barrierat dhe faktorët që ndikojnë në zbatimin e inovacionit në sektorin bujqësor, janë vlerësuar duke përdorur shkallën Likert [1-5].

Figura 10. Ndikimi i inovacionit në efikasitetin e aktiviteteve dhe shërbimeve në fermën/agroturizmin tuaj?




Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025

Rezultatet, nxjerrin në pah një perceptim kryesisht pozitiv të fermerëve mbi ndikimin e inovacionit në përmirësimin e efikasitetit të aktiviteteve dhe shërbimeve në fermat e tyre. Shumica e të anketuarve e vlerësojnë “Maksimalisht”, “Shumë” dhe “Mesatarisht”, përkatësisht (15%), (27%) dhe 38%). Kjo tregon se fermerët që zbatojnë dhe përdorin teknologji dhe praktika të reja inovative, kanë përfitime në aspektin e reduktimit të kostove, kursimeve të kohës, rritjes së produktivitetit, si përmirësimit të aktiviteteve dhe shërbimeve.

Një pjesë e vogël e fermerëve (anketuarve) vlerësojnë “Pak” dhe “Aspak”, përkatësisht (14%) dhe (6%), ndikimin e inovacionit në efikasitetin e aktiviteteve dhe shërbimeve të tyre. Kjo tregon zbatimin e pjesshëm të praktikave inovative si rezultat i kufizimeve, të tilla si akses i kufizuar në burimet financiare, njohuritë teknike dhe profesionale të pamjaftueshme, infrastruktura dixhitale e papërshtatshme.

Rezultatet tregojnë, se inovacioni rrit produktivitetin dhe menaxhimin operacional të aktiviteteve dhe shërbimeve të fermave bujqësore dhe agroturistike në sektorin bujqësor. Mbizotërimi i vlerësimeve pozitive sinjalizon një potencial të fortë për adaptimin dhe zbatimin e inovacionit në sektorin rural.

Figura 11. Roli i inovacionit në performancën e fermës/agroturizmin tuaj?



Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025


Rezultatet në figurën e mësipërme, tregojnë një vlerësim pozitiv nga të anketuarit për rolin e inovacionit në performancën e fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve agroturistike. Shumica e të anketuarve e vlerësojnë atë “Maksimalisht”, “Shumë” dhe “Mesatarisht”, përkatësisht (17%), (30%) dhe (34%). Kjo tregon se inovacioni luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e produktivitetit, efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve që operojnë në sektorin rural. Një pjesë e vogël e fermerëve (anketuarve) e vlerësojnë rolin e inovacionit “Pak” dhe “Shumë Pak”, përkatësisht me (13%) dhe (6%).

Përgjigjet e tyre nxjerrin në pah, pengesat strukturore për adaptimin e inovacionit, duke përfshirë kufizimet financiare, mungesën e njohurive, mbështetjen nga insitucionet publike dhe aksesin e kufizuar në infrastrukturën dixhitale.

Mbizotërimi i vlerësimeve pozitive nga të anketuarit tregon se inovacioni perceptohet gjerësisht si një nxitës kryesor i performancës së aktiviteteve të sipërmarrjeve agroturistike dhe fermave bujqësore. Vlerësimet e moderuara dhe të ulëta nga fermerët (të anketuarit), tregon dhe sinjalizon nevojën për politika dhe instrumenta mbështetës nga insitucionet publike në bashkëpunim me aktorë të tjerë, në drejtim të aksesit për burime financiare, transferimit të njohurive, trajnimet për fermerët, përmirësimit të infrastrukturës dixhitale në sekorin bujqësor.

Rezultatet e mësipërme, nxjerrin në pah rëndësinë e hartimit të politikave dhe mekanizmave mbështetës, për të nxitur dhe siguruar një zbatim të gjerë të inovacionit nga fermat bujqësore dhe agroturistike.

Figura 12. Barrierat dhe faktorët që ndikojnë në zbatimin e inovacionit në fermën/agroturizmin tuaj?



Burimi: Rezultatet e autorëve, 2025

Nga analiza e të dhënave që lidhen me barrierat dhe faktorët që ndikojnë në zbatimin e inovacionit nga fermat bujqësore dhe agroturistike, rezulton se shumica e të anketuarve vlerësojnë (maksimalisht, shumë dhe mesatarisht), kostot e larta për zbatimin e inovacionit dhe teknologjive përkatësisht me (18% 32% dhe 40%), mbështetjen nga institucionet dhe agjencitë publike (si grantet, subvencionet), përkatësisht me (29% 36% dhe 22%), aksesin në financim nga institucionet financiare, përkatësisht me (17%, 38% dhe 29%), mungesën e infrastrukturës dhe logjistikës së nevojshme, përkatësisht me (18%, 30% dhe 34%), mungesën e njohurive dhe aftësiwe profesionale të fermerëve, përkatësisht me (10%, 22% dhe 41%).

Informacioni dhe të dhënat e mësipërme janë të rëndësishme, për të identifikuar pengesat dhe faktorët që ndikojnë në adaptimin e inovacionit, me qëllim nxitjen dhe bashkëpunimin midis institucioneve publike dhe aktorëve të tjerë, në hartimin e politikave dhe strategjive që promovojnë dhe mbështesin, zbatimin e inovacionit në sektorin rural në Shqipëri.

Nga analiza e të dhënave dhe rezultateve të mësipërme, konkludojmë në disa gjetje kryesore:

Përmes të dhënave të mësipërme, analizuam shpërndarjen e pyetësorëve sipas rajoneve, karakteristikat e të anketuarve, të grupuara sipas gjinisë, moshës, arsimit dhe pozicionit të tyre. U analizua profili i biznesit (fermë bujqësore/agroturizëm), numri i të punësuarve, të dhënat për sipërfaqen e tokës, burimet e investimit/financimit, si dhe performanca për aktivitetet dhe shërbimet e ofruara në fermat bujqësore dhe sipërmarrjet agroturistike.

Referuar të dhënave mbi ndikimin që inovacioni ka në efikasitetin e aktiviteteve dhe shërbimeve të fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve agroturistike, rezulton se shumica e të anketuarve e vlerësojnë “Maksimalisht”, “Shumë” dhe “Mesatarisht”, përkatësisht (15%),

(27%) dhe 38%). Një pjesë e vogël e fermerëve (anketuarve) vlerësojnë “Pak” dhe “Aspak”, përkatësisht (14%) dhe (6%).

Sa i përket, rolit të inovacionit në performancën e fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve agroturistike, fokusuar (në aspektin e përmirësimit të proceseve të prodhimit, formave të marketingut dhe shitjes së produkteve, diversifikimit të aktiviteteve, uljes së kostove, performancës së menaxhimit të burimeve njerëzore, rritjes së investimeve, të ardhurave, produktivitetit), rezulton se shumica e të anketuarve e vlerësojnë atë “Maksimalisht”, “Shumë” dhe “Mesatarisht”, përkatësisht (17%), (30%) dhe (34%). Një pjesë e vogël e fermerëve (anketuarve) e vlerësojnë rolin e inovacionit “Pak” dhe “Shumë Pak”, përkatësisht me (13%) dhe (6%).

Nga analiza e të dhënave, që lidhen me barrierat dhe faktorët që ndikojnë në adaptimin dhe zbatimin e inovacionit, rezulton se shumica e të anketuarve vlerësojnë (maksimalisht, shumë dhe mesatarisht), kostot e larta të zbatimit të inovacionit dhe teknologjive, aksesin në burimet e financimit, mungesën e infrastrukturës dixhitale, mbështetjen nga institucionet dhe agjencitë publike, si dhe njohuritë e nevojshme dhe aftësitë profesionale të fermerëve. Gjetjet dhe rezultatet tregojnë se inovacioni luan një rol kritik në rritjen e performancës dhe konkurrueshmërisë së fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve të agroturizmit, përmirësimin e efikasitetit dhe produktivitetit, diversifikimin e aktiviteteve dhe të ardhurave, veçanërisht për sipërmarrjet agroturistike që integrojnë aktivitetet bujqësore me shërbimet e agroturizmit.

Konkluzione

Përmes këtij studimi u ekzaminua roli dhe ndikimi i inovacionit në performancën e fermave bujqësore dhe agroturistike në Shqipëri. Në total, u plotësuan 672 pyetësorë, të shpërndarë në 12 rajone të vendit, duke ofruar një mostër të gjerë dhe përfaqësuese të fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve të agroturizmit.

Referuar të dhënave mbi rolin e inovacionit në efikasitetin e aktiviteteve dhe performancën e fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve agroturistike, të fokusuara (në aspektin e përmirësimit të proceseve të prodhimit, shitjes së produkteve ofrimit të shërbimeve, diversifikimit të aktiviteteve, uljes së kostove, performancës së menaxhimit të burimeve njerëzore, rritjes së investimeve, të ardhurave, produktivitetit), rezulton se, shumica e të anketuarve e vlerësojnë atë pozitivisht, nga mesatarisht në maksimalisht.

Nga analiza e të dhënave, në lidhje me barrierat dhe faktorët nxitës që ndikojnë në zbatimin e inovacionit në sektorin bujqësor, rezulton se shumica e të anketuarve perceptojnë dhe vlerësojnë, kostot e larta të zbatimit të inovacionit dhe teknologjive, aksesin në burimet e financimit, mungesën e infrastrukturës dixhitale, mbështetjen nga institucionet dhe agjencitë publike, si dhe njohuritë e nevojshme dhe aftësitë profesionale të fermerëve.

Gjetjet e studimit, tregojnë se inovacioni luan një rol kritik në rritjen e performancës dhe konkurrueshmërisë së fermave bujqësore dhe sipërmarrjeve agroturistike. Inovacioni po bëhet gjithnjë e më shumë një faktor kyç për transformimin bujqësor dhe zhvillimin rural, veçanërisht në kontekstin e vendeve në zhvillim, siç është vendi ynë.

Inovacioni dhe dixhitalizimi kanë potencialin të sjellin një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si funksionon bujqësia, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së proceseve të punës, përmes teknologjive të reja dhe ideve inovative, të cilat mund të jenë më tërheqëse për të rinjtë në iniciativat e tyre sipërmarrëse.

Zhvillimi i sektorit bujqësor, shoqërohet me sfida që lidhen me rritjen e produktivitetit të fermave bujqësore, efikasitetin e përdorimit të burimeve, qasjen në financim, bashkëpunimin midis fermerëve dhe aktorëve të tjerë, cilësinë dhe sigurinë e ushqimit, zbatimin e praktikave inovative dhe teknologjive dixhitale, si dhe ndërtimin e kapaciteteve administrative për të mbështetur këto procese.

Burimet njerëzore (aftësitë dhe njohuritë e fermerëve) janë të rëndësishme për adaptimin e inovacionit në fermat e tyre. Rritja e aftësive dhe kapaciteteve, veçanërisht për fermerët e vegjël, për të menaxhuar me sukses aktivitetet e tyre bujqësore kërkon investime të qëndrueshme.

Kërkimi dhe zhvillimi, aftësitë profesionale, transferimi i njohurive dhe trajnimi i fermerëve janë të rëndësishëm në zbatimin e teknologjive dhe praktikave të reja inovative. Një rol vendimtar në transferimin e njohurive, trajnimin, edukimin dhe këshillimin e fermerëve për zbatimin e praktikave inovative dhe teknologjive dixhitale në sektorin bujqësor, luajnë institucionet publike, agjensitë e ekstensionit bujqësor në bashkëpunim me universitetet dhe aktorë të tjerë.

Gjetjet e studimit evidentojnë, rëndësinë e politikave dhe mekanizmave mbështetës për të nxitur dhe promovuar inovacionin si një komponent i rëndësishëm për rritjen e performancës së fermave bujqësore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit rural.

Duke marrë në konsideratë migrimin e popullsisë nga zonat rurale, është e nevojshme të inkurajohen dhe mbështeten të rinjtë në iniciativat e tyre sipërmarrëse, në lidhje me zbatimin e teknologjive të reja dhe praktikave inovative.

Bashkëpunimi midis institucioneve publike, agjensive të ekstensionit bujqësor, universiteteve dhe aktorëve të tjerë, luajnë një rol kyç në hartimin e politikave dhe strategjive, për nxitjen e inovacionit dhe dixhitalizimit në sektorin bujqësor.

Rekomandime

Rritja e aksesit të financimit në sektorin rural, për të mbështetur zbatimin e inovacionit nga fermat bujqësore dhe sipërmarrjet agroturistike.

Përmirësimi i njohurive dhe aftësive profesionale të fermerëve, përmes programeve të trajnimit, ofrimit të ekspertizës dhe mbështetjes teknike, nëpërmjet bashkëpunimit të agjensive publike, institucioneve akademike dhe aktorëve të tjerë.

Ofrimi i programeve të edukimit të vazhdueshëm për zbatimin e ideve inovative dhe teknologjive dixhitale, me fokus të veçantë iniciativat sipërmarrëse të rinjve në zonat rurale.

Rritja e mbështetjes nga institucionet dhe agjensitë publike, për të nxitur inovacionin dhe dixhitalizimin, si instrumente të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit rural.

Zhvillimi dhe sigurimi i infrastrukturës së nevojshme dixhitale për të lehtësuar zbatimin e inovacionit dhe dixhitalizimit në sektorin bujqësor.

Nxitja e bashkëpunimit midis fermerëve dhe aktorëve të tjerë, për të mundësuar ndarjen e njohurive dhe integrimin më të mirë në zinxhirin e vlerës në sektorin bujqësor.

Hartimi dhe zbatimi i një strategjie kombëtare gjithëpërfshirëse për inovacionin dhe dixhitalizimin në sektorin bujqësor, në përputhje me politikat, kriteret dhe standardet e Bashkimit Europian.

Rezultatet dhe gjetjet e studimit, nxjerrin në pah rolin e inovacionit si një faktor i rëndësishëm për transformimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit rural në vendin tonë.

Mirënjohje

Ky studim, është financuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKShI) dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës, në kuadër të projektit PTI 2024-2025, me titull: “Hulumtimi dhe vlerësimi i rolit të inovacionit në performancën e sipërmarrjeve agroturistike dhe fermave bujqësore”. Ne shprehim mirënjohjen dhe falenderojmë, Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës për financimin dhe mbështetjen e tyre në realizimin e këtij studimi.

Referencat

- Apicella, A., & Tarabella, A. (2024). Innovation in farming: Drivers of adoption of Precision Agriculture amongst farmers. *International Journal Food System Dynamics*, 15 (6), 2024, 671-683. <https://dx.doi.org/10.18461/ijfsd.v15i6N7>.
- Annosi, M. C., Raez, R. M. O., Appio, F. P., & Del Giudice, T. (2022). An integrative review of innovations in the agricultural sector: The roles of agency, structure, and their dynamic interplay. *Technological Forecasting and Social Change*, 185 (2022), 122035. <https://www.sciencedirect.com/science/article/abs/pii/S004016252200556X>.
- Balayev, A. R., & Mirzayev, S. N. (2022). Digital agricultural technologies for sustainable rural development: opportunities and barriers. *International Scientific Conference, Engineering for Rural Development*, 2022, pp. 34-40. DOI: 10.22616/ERDev.2022.21.TF009.

- Benfica, R., Chambers, J., Koo, J., Alejandro Nin-Pratt, Falck-Zepeda, J., Stads, G.J., & Arnd, C. (2023). Food System Innovations and Digital Technologies to Foster Productivity Growth and Rural Transformation. *Science and Innovations for Food Systems Transformation*, 421-438, https://doi.org/10.1007/978-3-031-15703-5_22.
- Blakeney, M. (2022). Agricultural Innovation and Sustainable Development. *Sustainability*, 2022, 14, 2698. <https://doi.org/10.3390/su14052698>.
- Bhujel, R.R., & Joshi, H.G. (2024). Factors influencing the adoption of sustainable agricultural practices in rural regions of developing countries: a review. *Food Research*, 8 (4), 81 - 89. [https://doi.org/10.26656/fr.2017.8\(4\).400](https://doi.org/10.26656/fr.2017.8(4).400).
- Campuzano, L.R., Hincapié Llanos, G.A., Zарtha Sossa, J.W., Orozco Mendoza, G.L., Palacio, J.C., & Herrera, M. (2023). Barriers to the Adoption of Innovations for Sustainable Development in the Agricultural Sector - Systematic Literature Review (SLR). *Sustainability* 15, 4374. <https://doi.org/10.3390/su15054374>.
- Chmieliński, P., & Wieliczko, B. (2022). Research and innovation challenges for better policies in food systems and bioeconomy transitions - evidence from Poland. *International Food and Agribusiness Management Review*, 25 (5), 789-802. <https://doi.org/10.22434/IFAMR2021.0156>.
- Diao, X., Reardon, T., Kennedy, A., DeFries, S. R., Koo, J., Minten, B., Takeshima, H., & Thornton, P. (2023). The Future of Small Farms: Innovations for Inclusive Transformation. *Science and Innovations for Food Systems Transformation*. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-031-15703-5_10.
- Domi, F., Domi, S., & Kapaj, I. (2023). The role of farm diversification on fostering innovation; the case of Agritourism. *International Conference on Agriculture and Life Sciences (ICOALS 4)*, 01- 03 November, 2023, 184-186. https://icoals4.com/wp-content/uploads/2023/10/25.10.23_proceedings-ICOALS-4.pdf.
- FAO. (2018). FAO's work on agricultural innovation: Sowing the seeds of transformation to achieve the SDGs. <https://www.fao.org/3/CA2460EN/ca2460en.pdf>.
- Ferrari, A., Bacco, M., Gaber, K., Jedlitschka, A., Hess, S., Kaipainen, J., Koltsida, P., Toli, E., & Brunori, G. (2022). Drivers, barriers and impacts of digitalisation in rural areas from the viewpoint of experts. *Information and Software Technology*, 106816. <https://doi.org/10.1016/j.infsof.2021.106816>.
- Finger, R. (2023). Digital innovations for sustainable and resilient agricultural systems. *European Review of Agricultural Economics*, Vol 50(4), pp. 1277–1309. doi:<https://doi.org/10.1093/erae/jbad021>.
- Frick, F., Vrolijk, H., & Sauer, J. (2024). Innovation behavior and sustainability performance: Empirical evidence on the farming sector. *Q Open*, 4(2), 2024, qoae032, <https://doi.org/10.1093/qopen/qoae032>

- Fuetsch, E. (2022). Innovation in Family Farms: The Roles of the Market, the Family, and Farm Performance. *Journal of Small Business Strategy*, 32(2), 83–103. <https://doi.org/10.53703/001c.31714>.
- Holland, R., Khanal, A.R., & Dhungana, P. (2022). Agritourism as an Alternative On-Farm Enterprise for Small U.S. Farms: Examining Factors Influencing the Agritourism Decisions of Small Farms. *Sustainability* 2022, 14, 4055. <https://doi.org/10.3390/su14074055>.
- INSTAT. (2025). Online Database 2023&2024. Available at: <http://databaza.instat.gov.al/>; <https://www.instat.gov.al/al/statistika/>.
- Kolaj, R., Arabska, E., & Borisov, P. (2024). Agricultural knowledge and innovation system in Albania: innovation performance, universities and two arguments. *Journal of Innovations and Sustainability*, 8(2). 01. <https://doi.org/10.51599/is.2024.08.02.01>.
- Kurtaj, D., Çerpja, T., Murtja, A., (2024). Financial Risk Analysis - Case study Guri i Zi in the Municipality of Shkodër in Albania, *WSEAS Transactions on Environment and Development*, Volume 20, 2024, 66-75. DOI: 10.37394/232015.2024.20.8.
- Kurtyka-Marcek, I., & Kutkowska, B. (2017). Innovation in Rural Tourism. *Journal of Agribusiness and Rural Development*, 16 (2), 383–392. <https://doi.org/10.17306/J.JARD.2017.00257>
- MARD - Ministry of Agriculture and Rural Development (2022). Rural Development Programme 2021-2027, Under Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA). https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Programi-IPARD-III_2021-2027.
- MARD - Ministry of Agriculture and Rural Development (2024). National Strategy of Agritourism Development in Albania. <https://bujqesia.gov.al/>.
- MSU-Manage. (2021). Innovations in Agricultural Extension. A joint publication of Michigan State University (MSU) Extension, East Lansing, Michigan, U.S.A., and the National Institute of Agricultural Extension Management (MANAGE), Hyderabad, India. https://www.aatf-africa.org/wp-content/uploads/2021/02/Innovations-In-Agricultural-Extension_Michigan-State-University.pdf
- Mulliri, J., Baraku, B., & Shahu, M. (2022). Digital technology - the case of Albanian agriculture. *International Journal of Economics, Commerce and Management*, United Kingdom, Vol. X, Issue 3, March 2022, pp. 106-112. <http://ijecm.co.uk/>.
- Murtja, A., Kurtaj, D., Ndrejoni, A., Prendi, Ll., (2023). Vegetable Farmers' Perception of Production Risk Sources and Environmental Aspects – Descriptive Statistical Analysis and Multifactorial Linear Regression, *WSEAS Transactions on Environment and Development*, Volume 19, 2023, 826-835. DOI: 10.37394/232015.2023.19.77

- OECD. (2013). *Agricultural Innovation Systems: A Framework for Analysing the Role of the Government*, OECD Publishing, Paris. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264200593-en>.
- OECD/Eurostat. (2018). *Oslo Manual 2018: Guidelines for Collecting, Reporting and Using Data on Innovation*, 4th Edition, The Measurement of Scientific, Technological and Innovation Activities. OECD Publishing, Paris/Eurostat, Luxembourg. <https://doi.org/10.1787/9789264304604-en>.
- OECD. (2019). *Innovation, Productivity and Sustainability in Food and Agriculture: Main Findings from Country Reviews and Policy Lessons*, OECD Food and Agricultural Reviews, OECD Publishing, Paris. <https://doi.org/10.1787/c9c4ec1d-en>.
- Olum, S., Gellynck, X., Ongeng, D. and Hans De Steur (2018). Farmers' adoption of agricultural innovations: A systematic review on willingness to pay studies. *Outlook on Agriculture*, Volume 49, Issue 3. <https://doi.org/10.1177/0030727019879453>
- Parikoglou, I., Emvalomatis, G., Läpple, D., Thorne, F., & Wallace, M. (2024). The contribution of innovation to farm-level productivity. *Journal of Productivity Analysis*, 62, 239–255. <https://doi.org/10.1007/s11123-024-00728-0>.
- Prasetyo, P. E., & Setyadharma, A. (2022). Digitalization Technology for Sustainable Rural Entrepreneurship and Inequality. *Journal of Human Resource and Sustainability Studies*, 10, 464-484. <https://doi.org/10.4236/jhrss.2022.103028>.
- Šermukšnyte-Alešiuniene, K., & Melnikiene, R. (2024). The Effects of Digitalization on the Sustainability of Small Farms. *Sustainability* 2024, 16, 4076. <https://doi.org/10.3390/su16104076>.
- Tomorri, I., Keco, R., Shima, J., & Tomorri, K. (2025). Drivers, Barriers, and Impact of Digitalization on Sustainable Rural Development, Focusing on Some Regions of Albania. *European Scientific Journal*, ESJ, 21(1), 115. <https://doi.org/10.19044/esj.2025.v21n1p115>.
- Tomorri, I., Domi, S., Çera, G., Keco, R., & Kapaj, I. (2024). Examination of the importance and level of application of digitization in the rural sector, the case of Albania. *WSEAS Transactions on Business and Economics*, Volume 21, 2024, 528-543. DOI: 10.37394/23207.2024.21.44.
- World Bank. (2016). *Will digital technologies transform agriculture in developing countries? Policy Research Working Paper 7669*. Washington, D.C. World Bank Group. <http://documents.worldbank.org/curated/en/481581468194054206/>.